



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 17**

**Datë: 03. 06. 2022. Ora: 13: 00**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.**

**Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.**

**SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.**

**ZRPPC: Nexhmedin Hyseni, drejtor i ZRPP**

**Përkthyesë: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.**

---

### **RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr.16/2022**
- 3. Aktivitetet e ZRPPC-së**
- 4. Raport i Këshillave të KQZ-së:**
  - Këshilli për Operacione Zgjedhore:**
    - Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Hartimin e Planit Strategjik të KQZ-së

- Shqyrtimi dhe miratimi i Ftesës për Vizitë studimore për përdorimin e Sistemit Elektronik të Identifikimit të Votuesve në Mal të Zi, përkrahur dhe financuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë
- **Këshilli për Çështje Ligjore:**
- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Prizren

## 5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për vëzhgimin e zgjedhjeve për Asamblenë Kombëtare në Slloveni 2022

## 6. Të ndryshme.

### 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

**Kreshnik Radoniqi:** Po fillojmë ! Mirësekeni ardhë...! Pastaj, kryetari Radoniqi, lexoi përmbajtjen e agjendës së mbledhjes, duke shtuar “Në të ndryshme!” një informatë për KQZ-në lidhur me një takim që ai ka pasur me përfaqësuesit e ODIR-it. Në kontekst, ai pyeti anëtarët e KQZ-së, nëse kanë ndonjë propozim për mbledhje...

**Arianit Elshani,** kërkoi që pika e KOZ-it të formulohet si “Rekomandim” rreth hartimit të strategjisë së planit të veprimit që përgatitet “grupi punues”, kurse rreth pikës së dytë, “nga shqyrtimi dhe miratimi i projektit të ftesës”, të jetë “të vizitës studimore” sepse kjo vizitë do të organizohet nga KQZ-ja me mbështetjen e OSBE-së, pra nuk ekziston ftesë por organizim...

**Alim Rama,** tha se nuk po shoh raportim nga Sekretariati, e duhet të vijë nga Sekretariati...

Me 10 vota për, miratohet rendi i ditës...

### 2. Aktivitetet e ZRPPC-së:

**Nexhmedin Hyseni,** drejtor i ZRPPC-së, raportoi mbi aktivitetet e zyrës mes dy mbledhjeve. Në fillim, ai tha se më 24 maj 2022, ZRPPC ka pranuar një “kërkesë” për informatë nga Zyra e Kryeministrit me nr. protokollit 722-2022, për verifikimin e Kandidatëve të cilët, janë përzgjedhur

për intervista në bordet e Drejtoreve: 1. Bordi i Drejtorëve Hekurudhat e Kosovës Train Kos SH.A. 2. Bordi i Drejtorëve Menaxhimi i Deponive Sh.A. 3. Bordi i Drejtorëve KUR-Hidroregjioni Jugor SH.A Prizren. 4. Bordi i Drejtorëve KUR-Bifurkacioni Sh.A Ferizaj. 5. Bordi i Drejtorëve KUR-Hidrodrini Pejë. Lidhur me këtë, tha z. Hyseni, zyra ka bërë verifikimin/krahasimin e listave me të dhënat e kandidatëve dhe, i është kthyer përgjigja në kërkesë për informatë Zyrës së Kryeministrit.

Po ashtu, me datë 31 maj 2022, Zyra ka pranuar edhe një “kërkesë” për informatë” nga Zyra e Kryeministrit me nr. protokoli 742-2022, për verifikimin e kandidatëve të cilët janë përzgjedhur për interviste Kompanitë Rajonale: Kompania Rajonale e Ujitjes Drini i Bardhë Sh.A, Pejë, dhe Kompania Rajonale e Ujësjiellit Hidrodrini Sh.A, Pejë. Lidhur me këtë kërkesë, Zyra ka bërë verifikimin/krahasimin e listave me të dhënat e kandidatëve dhe i është kthyer përgjigja në kërkesë për informatë Zyrës së Kryeministrit.

Me datë 25 maj 2022, përfaqësuesja e Zyrës znj. Vesa Xharra, ka vëzhguar kuvendin e pestë zgjedhor të Partisë Politike Eko Lëvizja e Gjellbër (ELGJ) të mbajtur në Prishtinë. Duke u bazuar në rrjedhën e punimeve të Kuvendit dhe implementimit të procedurave, Zyra konstaton se Kuvendi zgjedhor i partisë politike Eko Lëvizja e Gjellbër (ELGJ) janë bërë në përputhje me Statutin e partisë dhe Rregullat e KQZ-së.

Bazuar në aktivitetin nr.46 të Planit të Punës së KQZ-së për vitin 2022, Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim, ka organizuar tryezën me temën “Mbikëqyrja e Financave të Partive Politike–Nevoja për koordinim institucional”. Tryeza, është paraparë të mbahet me Kryetaren e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike në Kuvendin e Kosovës, Drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsion, Drejtorin e Administratës Tatimore dhe Prokurorinë e Shtetit. Dhe se, qëllimi i mbajtjes së kësaj tryeze rrjedh nga rekomandimet e Komisionit Evropian në Raportin e vendit për vitin 2020, ku theksohet nevoja për bashkëpunim më të mirë të Zyrës me autoritetet tjera kompetente. Kryetari i KQZ-së, z. Kreshnik Radoniqi, është njoftuar me rëndësinë e transparencës financiare të partive politike si domosdoshmëri për të siguruar besueshmëri të qytetarët për partitë politike, por edhe për të garantuar llogaridhënie të qytetarët për paratë që marrin nga buxheti i shtetit apo edhe nga donatorë të tjerë.

Me datë 1 qershor 2022, Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim ka mbajtur takim me delegacionin e OSBE/ODIHR-it (Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut) me seli në Varshavë, takimi ishte konsultativ që ndërlidhet me projektin në zbatim të ODIHR-it në Mbështetje të Zgjedhjeve në Ballkanin Perëndimor, në mënyrë më specifike lidhur me raportin përfundimtar për zgjedhjet komunale të vitit 2021 të Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Kosovë (EU EOM).

Me datë 1 qershor 2022, Zyra ka pranuar ftesë për monitorimin Kuvendit të nëntë (IX) zgjedhor të Partisë Politike Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), i cili kuvend do të mbahet të dielën me datë 5 qershor 2022, në Prishtinë, ku Zyra do të bëjë monitorimin e kuvendit zgjedhor të partisë në fjalë.

Ndërsa, me datë 1 qershor 2022, Zyra ka pranuar ftesë për monitorimin Kuvendit të Rregullt Zgjedhor të Partisë Liberale Egjiptiane - PLE, icili kuvend, do të mbahet me datë 3 qershor 2022, në Prishtinë, dhe se Zyra do bëjë monitorimin e kuvendit te partisë në përputhje me ftesën e pranuar.

**Sami Kurteshi**, pyeti nëse ka qenë takim apo tryezë për financa...?

**Nexhmedin Hyseni**, ka qenë ky një aktivitet që është mbajtur për herë të parë, meqë ish drejtori i zyrës e ka paraparë në plan të punës, dhe ne në bazë të planit të punës e kemi mbajte takimin koordinues...

**Kreshnik Radoniqi**: Në të ndryshme, kam menduar me ju informua për takimin që është mbajte, dhe takimin me OSBE/ODIR...

### **3. Raport i Këshillave të KQZ-së**

#### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

- **Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për Hartimin e Planit Strategjik të KQZ-së:**

**Arianit Elshani**: KOZ-I, e ka shqyrtuar planin e veprimit I rekomanduar nga SKQZ lidhur me hartimin e planit strategjik të KQZ-së. Ne këshill, kemi kërkuar që kjo të shqyrtohet brenda grupit punues, në mënyrë që ata të caktojnë afatet kohore. Pra, duke e ditur edhe nevojën, rëndësinë dhe ku do të përfshiheshin të gjitha rekomandimet, dhe nevojat reale. Sot, ne propozojmë krijimin e grupit me një përbërje të përzier: KQZ/SKQZ...në përbërje të krejt KQZ-së, të 11 anëtarët, dhe Sekretariati të përfshijë strukturat e veta...

Mendoj që, është koha që t'i japim propozimet, dhe grupi pastaj të sjellë një plan të veprimit..

**Alim Rama**: Parimisht, të jenë të gjithë anëtarët e KQZ, dhe për grupin punues mendoj që nuk duhet të ketë kuorum, sepse secili anëtarë dhe grupi mundet me dhanë kontributin e vetë...

**Sami Hamiti**, tha se është mirë të jenë 11 anëtarët, por punët teknike të mos mbesin barrë e KQZ-së por, të jetë e Sekretariatit sepse, prezenca e anëtarëve të KQZ-së mund të jetë më pak e pranishme. Por, barrën ta ketë Sekretariati... I japim orientimet, dhe në bazë të tyre të hartohet strategjia. Nga 2018 kemi mendue me ba strategjinë, po nuk e kemi ba...

Mendoj që, edhe afati të jetë fundi i nëntorit, ma herët nuk ka shans me u ba...

**Sami Kurteshi**: E kam lexue materialin, dhe kam përshtypjen se më është dukur I komplikuem materiali, dhe hapat nuk janë rregullua s'i është dashtë... Por, unë mendoj se strategjia, kur është fjala për afatin, nuk duhet të na zë 31 dhjetori pa strategji. E dyta, për cilën periudhë po duam ? Pra, duhet me pas një pikë të caktuar, së paku deri në mbajtjen e zgjedhjeve lokale të ardhshme.. Pra, duhet të shohim çka është realizuar, cilat çështje kanë ngecë, dhe mandej me filluar me strategjinë e ardhshme. A kemi pas ne strategji ? Duhet ta shohim, se mbi bazën e saj ne nxjerrim konsekuencat.

Mendoj se, të gjithë anëtarët e KQZ –së duhet të marrin pjesë. Pajtohem që nuk duhet të ketë kuorum, por kjo është strategji për punën tonë dhe ne duhet të jemi rregullisht ! Jam që Sekretariati t'i ketë të angazhuar të gjitha fushat, departamentet...ata, të gjithë duhet me I dhënë inputet e veta...

Nuk jam që të shpejtojmë, por 31 dhjetori mos të na zë pa strategji...

Në këtë pikë, diskutoi edhe krye shefi z. Ahmetaj mbi rëndësinë e strategjisë, dhe kërkoi që KQZ ta diskutojë një afat të strategjisë se, për sa do të jetë...

**Čemailj Kurtiši:** Edhe unë mendoj që nuk duhet të ngutemi sepse ky dokument është plan strategjik. Se a do të jetë për 3, apo 5 vite, këtë do ta shohim por, ne të gjithë duhet të jemi të angazhuar. Të kemi sa më shumë ide të mira, dhe ne të kemi mundësi të zgjedhim...! Deri në fund të vitit, është mirë të kryhet sepse, të mos ketë afat por, plani të jetë sa më i përsosur...

Në vazhdim, diskutuan më tutje: Sami Hamiti, Alim Rama etj.

**Ilir Gashi:** Teknikisht, duhet të ketë një bartës, ndoshta kryetari...

**Kreshnik Radoniqi,** tha se në parim ne po pajtohemi që të formohet grupi punues, dhe sigurisht që do të kemi një rend... Pra, të themelohet grupi për hartimin e planit të veprimit Strategjik të KQZ-së për periudhën 2022 – 2026...?

**Burim Ahmetaj:** Llogaritet të jetë 2022 – 2025...!

**Kreshnik Radoniqi:** Atëherë, grupi punues do të themelohet nga të gjithë anëtarët e KQZ-së dhe të Sekretariatit ( të gjitha departamentet). Pra, kush është për...?

Miratohet me 10 vota formimi i grupit në përbërje nga të gjithë anëtarët e KQZ-së, dhe nga Sekretariati.

-Shqyrtimi dhe miratimi i Ftesës për Vizitë studimore për përdorimin e Sistemit Elektronik të Identifikimit të Votuesve në Mal të Zi, përkrahur dhe financuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë:

**Arianit Elshani:** Përmes një imelli, jemi njoftuar lidhur me ftesën për vizitë studimore për përdorimin e Sistemit Elektronik të Identifikimit të Votuesve në Mal të Zi, e që përkrahet dhe financohet nga Misioni i OSBE-së në Kosovë. Sekretariati i ka rekomandu KOZ-it që, datat optimale të implementimit janë 14-17 qershor 2022, në Podgoricë. Atje, do të demonstron përdorimi praktik i sistemit elektronik, dhe prezantimi i K-Vote!

Këto, janë shpjegimet rreth projektit, dhe tani mbetet prezantimi i emrave që do të marrin pjesë.

**Kreshnik Radoniqi**: Janë, gjashtë pasona që marrin pjesë... Të mos harroj, se unë e propozova në të ndryshme, po meqë po lidhen çështjet, po e them tani: Ne, patëm një takim me përfaqësues të ODIR-it, dhe diskutimi me ta ishte kryesisht rreth “identifikimit elektronik” ! Pra, që lidhet me udhëtimin studimorë në Mal të Zi. Ne, kërkuam që të financohet një studim të fizibilitetit të ne, çka edhe u pajtuan, por ata potencuan se rreth “identifikimit elektronik”, do të mbahet një takim në Tiranë, dhe u diskutua që edhe ne do të marrim pjesë...

Do ta vazhdojmë bashkëpunimin që, edhe te ne mund të organizohet një takim-konferencë dhe se, sigurisht ne do të jemi të përkrahur në këtë tematikë që, do të vazhdoj edhe më tutje...

Mbase, kush do të shkojë: unë, Kreshniku nga ID, dhe katër anëtarë nga KQZ...

Në këtë pikë, diskutuan Sami Kurteshi, Alim Rama, Ilir Gashi, Sami Hamiti.

Në fund, u vendos që të marrin pjesë...

***( Ndërprerje e stenogramit...)***

**Nexhmedin Hyseni**: Dua ta ngris një shqetësim: prej vitit 2011, personalisht nuk kam marrë pjesë në asnjë vizitë studimore ! Por, ftesa s’i kjo, përfshinë edhe persona të tjerë si Besnik Buzhala, Premtim Rrustemi që janë të ngarkuar me përgjegjësi, dhe ishte dashur të merrnin pjesë në trajnime. Institucioni ynë, asnjëherë nuk ka përfshi shumicën e zyrtareve në vizita studimore, përveç në rastet kur të këtylla aktivitete janë organizuar nga OSBE-ja. Unë për vete, nuk bëjë kërkesë, por të gjithë ta kemi trajtimin meritore...

**Kreshnik Radoniqi**: Këto janë vizita studimore, kanë të bëjnë me çështje tjera, dhe Kreshniku është personi më adekuat për këtë vizitë. E kam parasysh: Sekretariati, duhej ta bëjë këtë, dhe besoj që edhe ODIR, do të na ndihmojë, dhe unë edhe vetë kam mendimin që Sekretariati të involvohet më shumë...

**Arianit Elshani**, tha se edhe në KOZ, janë ngritur këto çështje dhe, më shumë t’i kushtohet rëndësi. Pra, ajo cka i takon Sekretariatit, është që të angazhohet, të bëjë planin dhe ne të jemi

të informuar mbi këto çështje...Ne, marrim ftesa nga jashtë, por ne se kemi një fokus të Sekretariatit që të ketë më shumë prioritet..

**Ilir Gashi:** Unë, propozoj që mbasi janë 6 pjesëmarrës që mbulohen nga OSBE, të shtohet edhe një me shpenzime nga KQZ... E, për temat e ngritura të diskutojmë herën tjetër...

Diskutuan më tej: Burim Ahmetaj, Kreshnik Radoniqi, që saktësoi “listën” e pjesëmarrësve:

Sami Hamiti, Gordana Llaban, Alim Rama ( me shpenzime të Sekretariatit), Ilir Gashi, Fazli Stollaj, Kreshnik Radoniqi, dhe Kreshnik Spahiu. ( me shpenzime të OSBE-së)

U miratua pjesëmarrja me 10 vota.

Në fund të kësaj pike, Ilir Gashi, kërkoi që Sekretariati të hartoj një “listë”, dhe të ketë një evidencë lidhur me vizitat e ndryshme: kush, sa ka qenë, në mënyrë që të ketë një shtrirje horizontale të barabartë...

### **Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Prizren:

**Kreshnik Radoniqi:** Këshilli ka trajtuar një zëvendësim të asamblistit në komunën e Prizrenit, kështu që i dorëhequri Osman Hajdari, është zëvendësuar me Tajar Susurin nga subjekti politik LVV. Çdo gjë ka qenë në rregull, prandaj kush është për...?

Me 9 vota për, miratohet ky zëvendësim.

### **4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për vëzhgimin e zgjedhjeve për Asamblenë Kombëtare në Slloveni 2022**

**Kreshnik Radoniqi,** paraqiti raportin e vëzhgimit të zgjedhjeve kombëtare në Slloveni, me pjesëmarrje, unë, Sami Kurteshi, Arianit Elshani dhe Burim Ahmetaj. Mbas shkuarjes, marrjes së akreditimeve, të nesërmen kemi vizituar 2 vendvotime në Lubjanë, dhe 1 vendvotim në Maribor.



Ne, kemi parë praktikat sllovene, disa të mira të aplikueshme dhe që janë më të lira, të kabinat për shembull...Disa, edhe mund të mos jenë. Detajet janë me shkrim në raport, ku kemi dhënë edhe rekomandime...Në raport, janë edhe fotografitë, sidomos votimi me nevoja të veçanta, dhe mund ta aplikojmë, sidomos sigurinë e votës...

Raporti përfshinë të dhënat e ndryshme, zhvillimin e numërimit preliminarë, pra gjithë procesin..

**Sami Kurteshi**: Ne, e kemi bërë raportin, dhe kjo duhet të bëhet praktikë e ardhshme. Ishte një përvojë e mirë, shumë e mirë... Kemi vizituar tri qendra, pra shumë vendvotime...Raporti është pjesë e përvojës, madje edhe për rregullat tona...Raporti ka vlerë, sepse ka konkluzione dhe rekomandime...

Lidhur me vizitën, diskutoi edhe **Burim Ahmetaj**, që shkoqiti si me rëndësi “mundësinë e votimit të hershëm” që në Kosovë nuk praktikohet, dhe, rregulli në Qendrat Votimit dhe Vendvotime ku, s’kishte fare tollovi...Po ashtu, edhe forma e numërimit: së pari bëhej numërimi preliminarë, e pastaj kryesuesi e merrte kutinë e VV-së pa përcjelljen e askujt, dhe e dorëzonte te ekipi i verifikimit që ishte krejt trupë tjetër, e pas kësaj rezultatet finalizoheshin....shpejt, kurse ne shpenzojmë një muaj deri në certifikim...

**Alim Rama**, tha se konkluzionet dhe rekomandimet duhet të shfrytëzohen nga praktika sllovene, sidomos rreth kabinave... Ligji nuk na pengon, dhe mendoj se kjo përvojë duhet të shfrytëzohet...

Diskutuan edhe: Sami Hamiti, Ilir Gashi, Arianit Elshani.

Në fund, kryetari Radoniqi, theksoi, duke qenë edhe qëndrim i gjithë anëtarëve të KQZ-së se, konkluzionet dhe rekomandimet të shfrytëzohen nga Sekretariati s’i pjesë dhe praktikë e mundshme inkorporomi në rregulloret dhe, praktikat e KQZ-së.

### **Të ndryshme !**

**Kreshnik Radoniqi**: Takimin që e kishim lidhur me mbikëqyrjen e financave të partive politike. Kjo, ka qenë edhe në plan të punës, pra mes KQZ-së, AAK, ATK dhe Prokurorinë e Shtetit. Pra, jemi zotuar që raportet e partive politike të shkëmbehen me institucionet e tjera. Ishte një takim

koordinues. Raportet e fundit janë trajtuar, ndërsa ATK pati një vërejtje mirëpo, kjo nuk ishte problem sepse ata do t'i trajtojnë problemet sipas ligjit...

Nëse ligji hynë në fuqi, ZRPP do t'i auditoj financat e partive politike, kurse ne do t'i procedojmë më tutje, tek agjencionet përkatëse...! Për vitin 2021, nuk janë bërë dhe ne s'kemi këtu auditim...

**Sami Hamiti**: Institucionet që i keni takuar, e kanë përgjegjësinë sipas detyrës zyrtare. Ne, kemi treguar vullnet, partitë dhe subjektet politike janë të regjistruar në ATK, prokuroria po ashtu, ka detyrat e veta, i shiko raportet se ka obligim... Nuk sanksionon zyra, por komisioni financiarë...

Zyra kombëtare e auditorit, raporti i auditorit ta jep negativ, mohim opinionit, të obligon si në rastin e ndërmarrjeve... Ne, nuk është fjala për transparencë, por ne e kemi detyrim dhe institucionet e kanë obligim... Merrni ju, përgjegjësinë tuaj sa ju takon, ata kanë përgjegjësitë e tyre...

**Për KQZ**

**Kreshnik Radoniqi, kryetar**

-----